



Njoftim publik

Drejtoria e Urbanizmit – Komuna e Prishtinës, ka filluar procedurën me numër nr. 05 – 015/02 – 253858/19 dt. 16.10.2019, përmes së cilës kërkohet të emërtohet rruga e cilat gjendet në ZK Prishtinë.

Rruga “SHAQIR IGRISHTA”, segmenti i të cilës shtrihet në këtë hapësirë, në kryqëzimin e saj me rrugën “NDUE PËRLLESHI” kishte shmangje në vazhdimësinë e saj, e si rezultat, në konsultime me Agjencinë Kadastrale e Kosovës, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës ka digjitalizuar (si rrugë të re) segmentin e dytë të rrugës. Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 6, pika 1.2., pika 1.2.1.2., pika 1.2.2. dhe pika 1.2.3., Neni 7, pika 1, pika 2, pika 2.1., 2.2. 2.3. dhe pika 2.4., të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2012 të MMPH – së, i ka dhënë kësaj rruge të re një kod të veçantë (kodi 10722) dhe ka bërë propozimin për emërtim e kësaj rruge.

Emri i propozuar: **“ILJAZ VRIONI” – (1882-1932)** Kryeministër i Shqipërisë në tri qeveri në vitet '20 të shekullit XX, diplomat, veprimtar politik.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 18.10.2019 deri më 01.11.2019, në E-mail adresën: urbanizmi@prishtine.gov.net

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2012 të MMPH – së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtim, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1 dhe 2, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në web-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ëeb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë si dhe kodi i rrugës përkatëse.



Nënshkrimi i Zyrtarit: _____